



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 23
Prishtinë, më 28 shtator 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Murselj Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Adem Grabovci.

Deputet të tjerë pjesëmarrës: Alma Lama

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON –auditor i përgjithshëm, Radojica Tomiq, ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Sllobodan Petroviq, zëvendëskryeministër dhe ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri- koordinatorë, KIPRED (staf mbështetës) Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 12.09.2011 dhe 14.09.2011,
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010,
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010.
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 12.09.2011 dhe 14.09.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12.09.2011 dhe 14.09.2011.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010

Kryetari – Opinioni është i pakualifikuar. Ministria për Komunitete dhe Kthim ka pranuar gjendjen faktike. Kërkoj sqarime lidhur me moszbatimin e rekomandimeve të vitit 2009, shtatë nga të cilat nuk janë shpalosur dhe janë në proces. Në cilën fazë janë zbatimi i këtyre rekomandimeve? Shpenzimi i buxhetit nuk është i mirë, pasqyrat financiare janë dorëzuar me kohë dhe mirë, por vetëm në një gjuhë, pse? Cilësia e informatave- pasqyrat vjetore financiare nuk janë shpalosur për avance të pambyllura dhe shpalosje jo të saktë të vlerave totale të pasurisë. Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative - kriteri ka qenë çmimi për njësi, kontrata është lidhur me çmimin fiks prej 19,897euro, pagesat e bëra deri më tani në fund të vitit tejkalojnë shumën e kontratës 45.348 euro. Pra, furnizimet janë bërë pa procedura, pa vendim, pse? Pagesat deri në fund të vitit kapin vlerën prej 64mijë 991euro. Ka tejkalim marramendës nga kontrata bazë.

Radojica Tomiq – Në Ministrinë për Kthim ka pas ndërrime ministrash dhe ministria aktualisht po punon që këto rekomandime të zbatohen. Ndoshta ftesa për pjesëmarrje në mbledhje do të duhej t'i drejtohej sekretarit të ministrisë, sepse sekretari është personi përgjegjës për veprimet në këtë periudhë, kështu që si ministër kam pak informacione dhe materialin nga sekretari e kam pranuar para tri ditësh. Nuk e di pse sekretari nuk merr pjesë në këtë mbledhje.

Kryetari – Ministri është personi i cili vendos që në mbledhje të marrin pjesë përpos ministrin edhe sekretari permanent i ministrisë si dhe drejtorët e departamenteve përkatëse. Në mungesë të tyre Komisioni është i hendikepuar. Kërkoj mendimin e anëtarëve të Komisionit nëse duhet vazhduar me shqyrtimin e mëtejshëm të këtij raporti apo të shtyhet shqyrtimi për një mbledhje tjetër?

Ramiz Lladrovci – Ishte i mendimit që mbledhja duhet të vazhdojë. Është përgjegjësi e sekretarit permanent që ta njoftoj ministrin për punën e ministrisë. Ministri mund të përgjigjet, Komisioni ka raportin dhe mbi bazën e tij do të vendos. Ministri duhet të përgjigjet para Komisionit, ndërsa është çështje e ministrit se pse nuk ka marrë për prezantim në mbledhje edhe sekretarin dhe drejtorët e departamenteve përkatëse.

Murselj Haljilji – Në këtë ministri nuk ka pasur ndërrime ministrash por ka përfunduar mandati i ministrit të mëparshëm. Ishte i mendimit që shqyrtimi i këtij raporti të shtyhet në mënyrë që ministri të përgatitet më mirë, sepse efekti i shqyrtimit të raportit do të jetë më i mirë.

Armend Zemaj – Tha se kemi të bëjmë me një problematikë të vazhdueshme sidomos me këtë ministri. Është e vërtetë që menaxheri kryesor sa i përket shpenzimeve është sekretari, mirëpo përgjegjësinë politike e ka ministri dhe Qeveria rreth të gjeturave. I njëjti sekretar permanent është shpërblyer edhe me një mandat nga po ky ministër dhe nga kjo Qeveri. Keqpërdorimet në këtë ministri duhet të trajtohen me seriozitet të madh, sepse kemi të bëjmë edhe me kualifikime

të veprave penale – në fushën e prokurimit. Nuk ka arsye për të shtyrë debatin, sepse përgjegjësia prapë bie mbi ministrin.

Kryesuesi konstatoi se të pranishëm ishin tetë deputet dhe Komisioni për mbikëqyrjen e Financave Publike me gjashtë vota “për” dhe dy “kundër” nxori këtë

Përfundim

Vazhdon, Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010.

Kryetari – Realizimi i pagesave në shpërpushje me punimin dhe vonesat në realizimin e projektit. Ministria nuk ka paraparë penale fare në vonesa. Ndonëse komisioni mbi pranimin teknik ka dhënë vërejtje megjithatë pagesa është bërë. Blerjet – ekstrakti bankar lidhur me përshkrimin e pagesave për tërheqjen e mjeteve me kredi kartelevë vërehen datat të cilat nuk harmonizohen me datat e faturës dhe me datat e agjendës të qëndrimit jashtë vendit. Shpenzimet për dreka, darka zyrtare nuk janë përcjellë me faturim me dokumentacion për arsyetim, vlera e pagesës ka shpërputhje dhe këtu ka nevojë për sqarim. Përdorimi i automjeteve zyrtare – nuk arsyetohen kilometrat e arsyetuara me nivelin e shpenzimeve. Dosjet e personelit nuk janë të radhitura sipas UA. Nënshkrimi i raporteve të pranura nga vet përfituesit e projektit. Agjensioni Kosovar për Përkrahje dhe Zhvillim nuk ka përmbushur kërkesat sipas memorandumit me ministrinë, pagesat janë kryer. Dobësitë janë vërejtur në mos implementim, nuk janë nënshkruar nga zyrtari përgjegjës dhe projekti ka mbet jashtë funksionit. Janë paguar në mënyrë retroaktive shujta nga subvencionet, borxhe të papërfunduara. Në pasqyra financiare janë paraqitur investimet kapitale që nuk kanë urdhër blerje dhe nuk janë të regjistruara në SIMFK. Kontrolla e brendshme sipas ZAP-it, nuk ka funksionuar dhe niveli profesional i tij nuk siguron një menaxhim të mirë. Konkluzioni i përgjithshëm ka të bëjë me një keqmenaxhim dhe keqpërdorim, pa kontroll adekuate. Kërkoi sqarim lidhur me këtë.

Armend Zemaj – Raporti është publikuar në qershor dhe i është dërguar edhe ministrit. Ministri duhet të marrë përgjegjësi politike për punën në këtë ministri. Çka ka ndërmarrë ministri lidhur me të gjeturat e ZAP-it apo situata po vazhdon të jetë e njëjtë?

Radojica Tomiq – Tha se nuk do të marrë përgjegjësi as politike për atë kohë kur nuk ka kryer punën në këtë ministri. Këto janë çështje për të cilat japin përgjigje sekretari dhe zyrtarët e tjerë të ministrisë. Në këtë moment nuk mund të jap asnjë përgjigje për arsye se për çështjet e cekura nuk ka përgjigje.

Sa i përket veprimeve të caktuara lidhur me këtë raport ka urdhëruar sekretarin dhe buxheti është zvogëluar për 3 milion euro. Ka pas ndryshime dhe shkarkime sa i përket furnizimeve, ka konkurs për drejtor të financave dhe shef të furnizimeve.

Ramiz Lladrovci – Komisioni punon mbi bazën e raportit të ZAP-it dhe ministri është i detyruar të raportoj para këtij komisioni se çka keni punuar lidhur me këto vërejtje gjatë gjashtë muajve që jeni ministër. Komisioni nuk kërkon përgjegjësi për kohën kur ministër ishte dikush tjetër, sepse institucionet funksionojnë kështu.

Radojica Tomiq – Raporti për këtë vit do të jetë pozitiv, në ministri janë ndërmarrë hapa konkret. Borxhet ka urdhëruar të mos ndodhin më. Por për gjashtë muaj e gjithë gjendja nuk mund të ndryshohet.

Valbona Dibra – Ministri duhet të jetë i informuar për ngjarjet që janë punuar gjatë vitit 2010. Lidhur me shfrytëzimin e veturave zyrtare, pyeti: a ka ndërmarrë diçka ministri për të shikuar se nga janë bërë këto shpenzime të udhëtimeve zyrtare? A ka marrë masa ministri për sqarim të

këtij fenomeni? Gjendja e pasurive kapitale dhe jokapitale sipas raportit ka disbalancë. A ka ndërmarrë hapa ministri për pasqyrimin e saktë të pasurisë në pasqyrat vjetore financiare?

Alma Lama – Tha se në mbledhje është dashur të jetë i pranishëm edhe sekretari i ministrisë sepse ai është personi që garanton vazhdimësinë institucionale. Ikja nga përgjegjësia siç prezanton ministri se nuk ka qenë ministër gjatë kohës për të cilën flet raporti i ZAP-it është një precedent shumë i rrezikshëm dhe shumë negativ, sepse në momentin që një zyrtarë merr postin ai edhe duhet të marrë përgjegjësi. Pyeti: A janë denoncuar raste në prokurori? A i ka kaluar kjo çështje drejtësisë, sepse shkeljet janë shumë të rënda?

Radojica Tomiq – Lidhur me shpenzimet e automjeteve administrata nuk e ka përfillur UA, ndërsa shpenzimet që janë krijuar gjatë vitit 2010, nuk kam informacione lidhur me këtë përgjegjësi bie mbi ata. Tani asnjë automjet nuk do të dal nga ministria pa u plotësuar urdhëresa dhe UA.

Policia dhe EULEX-i kanë marrë dokumentacionin dhe ata aktualisht janë duke u marrë me këtë çështje. Sa i përket sekretarit - ka pas një konkurs ka pas një komision për përzgjedhjen e tij domethënë përzgjedhjen e tij nuk e ka bërë ministri.

Komisioni vazhdoi punimet me dyer të mbyllura. (neni 65 i Rregullores së Kuvendit)

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike me pesë vota “për” dhe tri “kundër” nxori këtë

Përfundim

- 1. Kërkohet nga Ministria për Komunitete dhe Kthim që në afatin prej dhjetë (10) ditësh me raport me shkrim ta njoftoj Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me të gjeturat e ZAP-it.*
- 2. Raporti duhet të përmbaj edhe të gjitha të dhënat lidhur me veprimet e ndërmarra nga ministria, për përmirësimin e gjendjes.*

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010

Kryetari – Tha se Opinioni i ZAP-it, për pasqyrat financiare për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010, është “*Opinion i Pakualifikuar me theksim të çështjes*”. Domethënë janë disa të gjetura që duhet sqaruar dhe se në pasqyrat financiare nuk janë shpalosur të gjitha. Ministria është pajtuar me të gjeturat e ZAP-it. Kanë qenë 12 rekomandime, 6 janë adresuar, ndërsa janë në proces 6 të tjera. Disa nga të gjeturat janë përsëritur. Kërkoi sqarim lidhur me këtë.

Sllobodan Petroviq – Tha, edhe pse nuk ka qenë ministër në kohën për të cilën flet raporti megjithatë ndjen përgjegjësi që para Komisionit të prezantoj aktivitetin e tij lidhur me këtë, në mënyrë që të sigurohet që rekomandimet e auditorit të zbatohen. Raporti nuk ka identifikuar dëmtim material dhe pasqyrat financiare paraqesin realitet në çdo moment.

Furnizimi me dru – për ngrohje për të shpërngulurit në Mitrovicë, janë të regjistruara në kategorinë e kapitaleve duke pas parasysh se hyn në kategorinë mallra dhe shërbime, ky aktivitet ka qenë transparent me mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të ICO-së, pra gabimi ka të bëjë me kodin. Në raportin nëntë mujor për vitin 2010 është harruar jashtë raportit të Bankës Kombëtare, gabim që është lëshuar dhe është prezantuar në raportin përfundimtar të vitit të kaluar. Këto gabime janë të paarsyeshme pavarësisht që arsyetohen nga aspekti human dhe rastet e tjera nuk do të tolerohen.

Kjo ministri ka specifikat e veta në aspektin e planifikimit financiar. Kjo ministri me ligj ka pas në disponim buxhetin kotigjent që shfrytëzohet për themelimin e komunave të reja dhe kjo nuk është prezantuar në buxhetin vjetor dhe në kategorinë ekonomike, por me vendim të ministrisë dhe të ICO-së, për secilin rast shfrytëzohet për komunat e reja, për paga dhe për shërbime kapitale dhe investime. (për vitin që po raportohet ajo shumë ishte 3.4milion euro).

Ministria disponon me grande për bashkëfinancim nga KE-ja (2.5milion), me të cilat kanë disponuar organet lokale komunale dhe ata kanë marrë mbi 10 milion euro me të cilat drejtpërdrejtë komandon KE. Projektet sipas logjikës do të duhej të ishin të regjistruara në *“free balancë”* si kapital i ministrisë. Me ato mjete janë financuar shkollat parqet e kështu me radhë. Këto mjete nuk janë të regjistruara si kapital i ministrisë, sepse i takojnë komunave. Me këtë rast ministria ka zgjedhur një kahje të cilën e ka marrë si të saktë, pra raportim secila për përparësitë, çka domethënë shpenzimet janë të regjistruara të ministria, ndërsa vlerat e tjera të regjistrohen të komunat ku edhe është i regjistruar projekti.

Ministria po ashtu disponon me fond për subvencionin e komunave, për performanca më të mira. Këto mjete janë në kategorinë ekonomike. Drejtoria ka vlerësuar se këto janë kapitale për komuna dhe duke menduar se qytetarët kanë nevoja për shkolla rruge sesa për çështje të karakterit teknik, është marrë sugjerimin nga auditori që ato mjete nuk mund të investohen në investime kapitale dhe ministria do ta respektoj këtë.

Shpenzimet e telefonisë fikse-Auditori ka të drejtë limiti është shkelur dhe 1620euro janë tejkalim për shtatë muaj. Lidhur me këtë kjo është mbuluar nga pagat. Ministria është e obliguar të respektoj të gjitha obligimet dhe ka bërë planin operacional për të zbatuar të gjitha rekomandimet e ZAP-it dhe të Kuvendit.

Kryetari – Kërkoj nga auditori të sqaroj kualifikimin e raportit *“me theksim të çështjes”*.

Florim Beqiri, ZAP- Theksimi i çështjes ka të bëjë me mos shpalosjen e duhur të pasurive dhe mos shpalosjen e duhur e pagesave nga palët e treta e sidomos - ministria donacionin nga Banka Botërore, nuk e ka shpalosur se cilat nga komunat janë përfituese të këtij donacioni. Regjistrimi në kodet e gabuara dhe pagesat në kodet e gabuara. Shqetësim ka mbetur që shpenzimet për investime kapitale bëhen në tre mujorin e fundit. Dosja e personelit - kanë qenë disa pengesa administrative dhe ZAP-i ka marrë premtimin nga sekretari i ministrisë se këto do të evitohen.

Valbona Dibra – Ku qëndron problemi pse pagesat nuk janë shpalosur nga palët e treta? A mendoni se s`ka pasur transparencë rreth këtyre përfitimeve të komunave?

Pagesa e projekteve nga kategoria e subvencioneve – kërkoj sqarim se për çfarë projekti për mbikëqyrje profesionale janë ndarë shuma prej 30 mijë eurove? Kjo do të duhej të sqarohej edhe nga auditori pasi që është informacion i mangët në raport. Auditori ka pas qasje në të gjitha dokumentet, atëherë raporti është dashur të përmbaj më shumë informacione.

Besim Osmani, MAPL – Ministria ka pasur vështirësi në shpalosjen e palëve të treta – ky është një grand i Bankës Botërore i përcaktuar për vetëqeverisjen lokale në Kosovë. Autoriteti për shfrytëzimin e këtij grandit ka pas APP-ja e jo MAPL, sepse pikërisht me këtë agjension ka marrëveshje banka botërore dhe nuk pranon që dikush tjetër të procedoj në emër të këtij grandit. Ministria ka dërguar te auditort të gjithë materialin të cilin ministria ju ka mundësuar auditorëve ta shikojnë në APP, sepse ministria nuk i ka këto materiale. Përfitues të këtij kanë qenë më shumë se 20 komuna të Kosovës, në shuma të vogla dhe raportimi financiar bëhet nga një zyre e veçantë në emër të Qeverisë që është në Departamentin e Thesarit që stafi financohet nga Banka Botërore dhe shërbejnë për nevojat e Bankës Botërore. MAPL ka menduar se ky është një pozicion që nuk duhet prezantuar në pasqyrat financiare dhe kjo nuk është bërë në raportin e parë nëntë mujor. Menjëherë pas vërejtjeve të auditorit kjo është përfshirë. Ministria ka shpenzuar rreth 30 mijë euro për mbikëqyrjen e projekteve, është fjala 99 projekte kapitale që janë zhvilluar nëpër komuna.

Florim Beqiri, ZAP – Pas rekomandimeve të ZAP-it Ministria ka pasqyruar te tabelat e pranimeve mirëpo më detajisht ku kërkohet nuk ka shpalosur se kush kanë qenë përfitues të këtij donacioni. ZAP ka pasur qasje në të gjitha dokumentacioneve dhe kemi kërkuar që ministria të prezantoj më qartë në pasqyrat financiare.

Armend Zemaj – Komisioni nuk ndërhyt në raportet e ZAP-it, por gjuha e përdorur në këto raporte nga ana e auditorëve duhet të jetë e definuar saktë për opinionin publik. Procedurat e prokurimit – gjuha e përdorur thotë- ka pasur disa ndryshime të kode, por nuk theksohet se a është bërë ndonjë keqpërdorim. Kërkoj sqarim lidhur me këtë. Auditori i përgjithshëm duhet të fokusohet në krijimin e komunave të reja, sepse kemi raporte me mohim opinionit. Gjuha e përdorur duhet të jetë e saktë. A ka keq - menaxhim?

Florim Beqiri, ZAP – Nëse ka keqpërdorim ose keq-menaxhim, zyra e auditorit nuk mund të dal me këtë konstatim, atë mund ta bëjë gjykata. Ndërrimi i kodeve ekonomike është një pasqyrim jo i saktë.

Besim Osmani, MAPL – Ministria në muajin nëntor është ballafaquar me një situatë shumë të keqe me të zhvendosurit në veriun e Mitrovicës. Auditori me të drejtë ka konstatuar këtë të gjetur ka keq-menaxhim, por jo keqpërdorim sepse nevoja ka qenë urgjente. Subvencionet - sipas LMFPF deri në 15% e shumës mund të ndryshohet dhe të bartet në kodin për investime kapitale. Ministria ka përdorur kodin e subvencioneve dhe ministria me vërejtjen e auditorit do të mundohet të mos e përsërisë këtë.

Afrim Hoti – Pse 58% e buxhetit është shpenzuar në tre muajt e fundit?

Besim Osmani, MAPL – E njëjta gjendje do të përsëritet edhe në këtë vit, sepse ky proces nuk është në dorën e MAPL. Për zotim të mjeteve nevojitet që ministria në tremujorin e parë të ketë në dispozicion mjetet e alokuara në mënyrë që të fillohen procedurat që së paku në muajin shtator të fillohet me pagesa. Sipas marrëveshjes, procedurat e prokurimit i kryejn komunat e Kosovës. Ministria e financon projektin dhe procedurën e prokurimit e kryen komuna.

Alma Lama – Në vitin 2010 keni pasur në dispozicion mjetet buxhetore që në fillim të vitit dhe kjo ka ndodhur edhe vitin e kaluar.

Besim Osmani, MAPL – Ministria nuk ka pasur as vitin e kaluar në fillim të vitit mjetet në dispozicion. LMFPF thotë se ndarjet buxhetore dhe alokimet bëhen në baza tre mujore dhe në këtë rast ministria nuk ka mundur që në janar të marrë shumën për alokim të mjeteve apo në muajin shkurt. Nuk është në nivel të ministrisë që të zgjidhet kjo.

Ramiz Lladrovci – Shpenzimi i buxhetit edhe në tre muajt e fundit nuk përbënë shkelje, por bartë në vete rrezikun që mund të bëhen keqpërdorime. Pyeti: pse ka lejuar që dosja e personelit të mos azhurnohen mirë?

Besim Osmani, MAPL – Ministria ka pranuar këtë gabim. Listat e pagave nuk janë regjistruar. Kjo çështje nuk përbënë rrezik për keqpërdorim të mundshëm. Ministria ka bërë planin aksionar dhe është vërtetuar se nga janari deri në këtë muaj të gjithë zyrtarët kanë nënshkruar në listat e pagave.

Valbona Dibra - Problemi i shpenzimit të buxhetit në fund të vitit mund të evitohet. Prokurimi ka një plan të prokurimit dhe kjo është përgjegjësi e sekretarit dhe e drejtorit të prokurimit. Planifikimi duhet të jetë i mirë.

Besim Osmani, MAPL – Zakonisht në Ligjin për Buxhetin do të jetë secili projekt kapital i evidentuar dhe do të votohet nga Kuvendi. Specifika e kësaj ministrie është se Kuvendi miraton

shumën prej 2 milion e 400 mijë euro për komuna pa treguar se çka do të financohet gjatë vitit. Pastaj komiteti prej shtat personave brenda ministrisë evidenton prioritetet nëpër komuna. Kjo kërkon kohë dhe teknikisht është e pamundur të realizohet me kohë.

Alma Lama – Hartimi i buxhetit fillon gjashtë muaj paraprakisht, pse komunat nuk e bëjnë këtë gjë në mënyrë që të evitohet kjo? Investimet kapitale janë paraparë me buxhet dhe mund të shmangët kjo lloj situatë.

Komisioni vazhdoi punimet me dyer të mbyllura. (neni 65 i Rregullores së Kuvendit)

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010, nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

4. Të ndryshme

Kryesuesi – Ishte i mendimit që në mbledhjet e KMFP të ftohen edhe përfaqësuesit e AKKK dhe Prokurorisë së Kosovës. Kërkoj mendimin e anëtarëve të Komisionit lidhur me këtë.

Ramiz Lladrovci – Tha se edhe pse propozimi mund të jetë i saktë, por tha se më këtë propozim vetëm shtohen shpenzime të panevojshme. Prokuroria sipas ligjit përcjell raportet e ZAP-it dhe ka për detyrë që të vlerësoj nëse duhet ta hetoj rastin ose jo.

Valbona Dibra – Meqenëse mbledhjet e Komisionit janë të hapura, raportet e ZAP-it janë të publikuara dhe kjo nuk është në kompetencë të Komisionit të veproj kështu.

Bali Muharremaj – Shkeljet janë të mëdha dhe për këtë duhet bërë diçka. Ka një keq-menaxhim dhe lidhur me këtë duhet bërë diçka.

Albert Kinolli – Komisioni në kuadër të kompetencave ka kryer punën e tij dhe lidhur me veprimet e mëtutjeshme duhet të merret vendimi në të mirë të qytetarëve, sepse ata janë taksapaguesit.

Mursel Haljilji – Tha se mund të bëhet një ftesë e përgjithshme, pastaj ata vendosin nëse duan të jenë të pranishëm apo jo.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu